Ministri
1031
3.4.1995

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

# VENDIM

Nr. 142 datë 27.3.1995

PËR

## KRIJIMIN E QENDRËS KOMBËTARE TË INVENTARIZIMIT TË PASURIVE KULTURORE

Për dokumentimin e saktë shkencor të pasurive kulturore, si dhe për studimin, botimin dhe propogandimin e tyre, me propozimin e Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve, Këshilli i Ministra

V E N D O S I :

1. Krijimin e Qendrës Kombëtare të Inventarizimit të Pasuriv Kulturore, me objekt inventarizimin, ruajtjen, propogandimin dhe studimin e pasurive kulturore kombëtare, si institucion buxhetor në vartësi të Ministrisë së Kulturës, Rinisë dhe Sporteve.

2. Selia e saj vendoset në dhomat e aneksit të katit të tret të SHB Enciklopedike.

3. Në buxhetin e vitit 1995, për Ministrinë e Kulturës, Rinisë dhe Sporteve të përfshihet numri i punonjësve prej gjashtë vetash dhe fondi përkatës për këtë institucion.

4. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Ministria e Kultur Rinisë dhe Sporteve dhe Ministria e Financave.

Ky vendim hyn në fuqi më 15 prill 1995.

KRYETARI I KËSHILLIT TË MINISTRAVE

ALEKSANDËR MEKSI

Nr.prot.838/1

Datë 29.3.1995

PRESIDENCËS
KUVENDIT POPULLOR
GJYKATËS KUSHTETUESE
GJYKATËS SË KASACIONIT
GJYKATËS SË APELIT
PROKURORISË SË APELIT
PROKURORISË SË PËRGJITHSHME
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË KULTURËS,RINISË DHE SPORTEVE
MINISTRISË SË FINANCAVË
SHËRBIMIT TË KONTROLLIT TË SHTETIT

TIRANË

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

VULLNET ADEMI

REPUBLIKA ... KËSHILLI I MINISTRAVE